

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve: I., J., E., B. H., që të gjithë nga P., rr. “...” nr.124, për shkak të veprave penale në bashkëkryerje Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së dhe Dëmtim prone nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe Y. S. nga fshati R., Komuna e Podujevës, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.360/2013, të dt.23.02.2015, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 24.03.2017, në praninë e Prokurorit të Shtetit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë - Ajshe Ferati dhe të akuzuarve I., J., E., B. H. dhe Y. S., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 19.04.2017 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. Të akuzuarit:

1. I. H., nga i ati I. dhe nëna V., e vajzërisë D., i lindur me datë *data e lindjes...*, nga P., rr. “...” nr.124, me numër personal: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme teknike, bujk, i martuar baba i 4 (katër) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

2. J. H., me nofkën “J.”, nga i ati I. dhe nëna V., e vajzërisë D., i lindur me datë *data e lindjes...*, nga P., rr. “...” nr.124, me numër personal: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, shofer, i martuar baba i 4 (katër) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

3. E. H., nga i ati J. dhe nëna S., e vajzërisë G., i lindur me datë *data e lindjes...*, nga P., rr. “...” nr.124, me numër personal: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

4. B. H., me nofkën “T.”, nga i ati I. dhe nëna E., e vajzërisë B., i lindur me datë *data e lindjes...*, nga P., rr. “...” nr.124, me numër personal: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R Ë

Sepse:

Me datë 09.01.2013, rreth orës 12:20, në rr. S.-Z. P. përballë “Beni Donës”, të pandehurit I. H., J., E., B. dhe B.H., pas një mosmarrëveshje të atëçastshme me të dëmtuarin Y. S. lidhur me itinerarin e transportit të udhëtarëve në relacionin P.-P., të cilët gjatë rrugës kishin ngadalësuar shpejtësinë e autobusit nën pretekstin se gjoja kanë pasur defekt të njëjtin në momentin kur i dëmtuari kishte ndalur autobusin që ti zbres udhëtarët, kanë shkuar tek autobusi i tij dhe kanë filluar që ta sulmojnë fizikisht, duke tentuar që ta kacavarin për pasqyrë si dhe duke goditur autobusin e tij në pjesë të ndryshme me mjete të forta duke ia thyer parafangon dhe xhamin e derës së majtë,-

- me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Sulm nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 187 par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 450, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i

G J Y K O N

Të akuzuarit: **I. (I.) H., J. (I.) H., E. (J.) H., B. (I.) H.**, me **dënim me kusht**, ashtu që i'u shqipton **secilit veç e veç** dënim me **burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajsh**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse të akuzuarit **në afat prej 1 (një) viti** nuk kryjnë vepra të reja penale.

DETYROHEN të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushalle të paguajë **secili veç e veç** shumën prej **30.00€ (tridhjetë euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Ndaj të akuzuarve të njëjtë me të dhëna si më lartë:

Në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,

R E F U Z O H E T A K U Z A

Sepse:

Me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin nën I, të akuzuarit I., J., E. dhe B. H. duke e goditur autobusin e tij në pjesë të ndryshme me mjete të forta duke ia thyer parafangon dhe xhamin e derës së majtë,-

- me këtë në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale Dëmtim prone nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sepse gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër penale me datën 09.01.2017.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

III. Ndërsa ndaj të akuzuarit:

5. Y. S., nga i ati A. dhe nëna N., i lindur me datë *data e lindjes...*, nga fshati R., Komuna e P., Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

Me datë 09.01.2013, rreth orës 12:20, në rr. S.-Z. P. përballë “Beni Donës”, i pandehuri Y. S., pasi është sulmuar nga të akuzuarit si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze e me qëllim që t’i shmanget sulmit lëvizë me autobusin e tij dhe gjatë lëvizjes e godet të dëmtuarin I. H., me ç’rast i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

- me këtë kishte për të kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Sepse gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër penale me datën 09.01.2017.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën, PP.II.nr.360/2013, të dt.23.02.2015, kundër të akuzuarve: I., J., E., B. dhe B. H., që të gjithë nga P., rr. “...” nr.124, për shkak të veprave penale në bashkëkryerje Sulmi nga neni 187 par.1 dhe Dëmtim prone nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe Y. S. nga fshati R., Komuna e P., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 14.03.2017 dhe 24.03.2014, në të cilën prezantuan Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë Ajshe Ferati dhe të akuzuarit I., J., E. dhe B. H., si dhe Y. S., ndërsa nuk prezantoi i akuzuari B.H. për të cilin gjykata ka lëshuar Urdhëresë drejtuar Stacionit Policor në Podujevë për verifikim e adresës dhe dorëzimin e ftesës për seancë.

Në seancën e dt.14.03.2017 gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës me morri aktvendim për hudhjen e pjesërishme të aktakuzës së Prokuroria Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.360/2013, të dt.23.02.2015, pushimin e procedurën penale ndaj të pandehurve I., J., E. dhe B. H. për veprën penale Dëmtim prone nga neni 333 par.1 lidhur

me nenin 31 të KPRK-së, si dhe Y. S. për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, në kuptim të nenit 106 par.1 pika 1.6 dhe nenit 107 par.8 të KPRK-së.

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar të dt.24.03.2017, me propozimin e prokurorit të shtetit dhe me pajtimin e palëve mori aktvendim për veçimin e procedurës penale kundër të pandehurit B. H., me qëllim të efikasitetit të procedurës penale kundër të pandehurve të tjerë, për shkak se nga informata e stacionit policor të dt.21.03.2017, thuhet se i pandehuri B. H. ndodhet në shtetin e Anglisë.

Të akuzuarit I., J., E. dhe B. H. në seancën e shqyrtimit fillestar të dt.24.03.2017 deklaruan se e pranojnë fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, pendohen për veprën penale të kryer, me palën e dëmtuar nuk kanë kurrfar problemi, kanë raporte të mira dhe kërkojnë nga gjykata një dënim sa më të butë.

Prokurori shtetit Ajshe Ferati në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit ka deklaruar se e mbështesë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, ngase është bërë me vullnetin e lirë dhe konform dispozitave të nenit 248 të KPPRK-së.

I dëmtuari Y. S. në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, si dhe aktakuza nuk përmbanë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet të akuzuarit, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarve përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale në bashkëkryerje Sulm nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se të akuzuarit në aspektin penal-juridik janë përgjegjës dhe të njëjtit i shpalli fajtorë dhe u shqiptoi dënim si në dispozitivin nën I. të këtij aktgjykimi.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti vetëm faktin se të akuzuarit gjatë shqyrtimit fillestar e pranuan në tërësi fajësinë për veprën penale e cila u vihet në barrë, duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe i gjykoj me dënim si në dispozitivin nën I. të këtij aktgjykimi, duke konsiderur se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore si dhe përgjegjësisë penale dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në

parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tyre dhe si masë parandaluese me efekt në persona të tjerë për moskryerjen e veprave penale të parapara sipas dispozitës së nenit 41 të KPRK-së.

Ndërsa sa i përket pikës II. dhe III. të këtij aktgjykimi gjykata konform nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së mori akrgjykim refuzues, ngase vërtetohet se ka arritur parashkrimi absolut të ndjekjes penale në kuptim të nenit 106 par.1 pika 1.6 dhe nenit 107 par.8 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale sa i përket pikës I. të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa sa i përket pikës II. dhe III. të dispozitivit marrë në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 dhe 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.173/2015 dt.19.04.2017

Sekretare juridike,
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.